

Drejt një të ardhmeje të qëndrueshme: Kur ekonomia qarkulluese fuqizon komunitetet.

“Është impresionuese të jemi bashkë në këtë sallë dhe të shohim se sa të ndryshme janë nismat, por nga ana tjetër se si të gjithë punojnë për një qëllim” - kështu dakordësuan pjesëmarrësit në platformën e Shkëmbimit të Njohurive, e cila u zhvillua më 29 Janar 2026, duke përfshirë 5 përfituesit kryesor nga skema e subgrantimeve të hapura në kuadër të thirrjes “Mëso të vlerësosh. Mos Shpërdoro!” si dhe përfituesit përfundimtar nga 5 projektet e zbatuara. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm krijoi një hapësirë frymëzuese për shkëmbim përvojash dhe njohurish. Ky bashkëpunim i gjerë i dha vlerë të shtuar eventit, duke theksuar rëndësinë e punës së përbashkët për ndërtimin e një mjedisi më të qëndrueshëm dhe fuqizimin e komuniteteve lokale.

Iniciativat u vlerësuan dhe u përgëzuan dhe nga paneli i mirëseardhjes nga Znj.Ermelinda Mahmutaj, Drejtore Ekzekutive në qendrën EDEN, Z. Marcel Thomkins Menaxher i Komponentit të Programit, Angazhimi i sektorit privat në GIZ Albania, dhe Z. Edvin Pacara, Menaxher Programi për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike në Delegacionin e BE në Shqipëri.

Gjatë eventit, Fondacioni Së Bashku, Albanian Craftsman Education, Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA Albania), Together for Life dhe Environmental & Territorial Management Institute (ETMI) ndanë përvojat e tyre, duke prezantuar punën, arritjet dhe ndikimin konkret që projektet e tyre kanë pasur në komunitete. Historitë e suksesit dhe qasjet inovative frymëzuan pjesëmarrësit dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit për krijimin e ndryshimeve të qëndrueshme.

“Jo për ne, pa ne”, një nga mesazhet kyç përcjellë nga Fondacioni Së Bashku, riktheu në qendër të vëmendjes rëndësinë thelbësore të përfshirjes aktive të komuniteteve me aftësi ndryshe në proceset e fuqizimit. Ky parim thekson domosdoshmërinë që këto komunitete të jenë pjesë e vendimmarrjes, duke mundësuar identifikimin dhe adresimin më të saktë të nevojave reale dhe krijimin e zgjidhjeve më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Shembuj insipirues u rrëfyen në event me anë të projektit të tyre *“Fuqizimi i personave me aftësi të kufizuara përmes ekonomisë qarkulluese”*, i shtrirë në 16 bashki të vendit, duke rikthyer në përdorim pjesë të përdorura dhe duke promovuar ripërdorimin e komponentëve, përfshirë edhe bateritë.

Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA of Albania) prezantoi nismën *“Eco – Girls”* së bashku me vajzat nga Shkodra, të cilat npërmjet talentit të tyre dhe kreativitetit sollën produkte të realizuara me materiale të ricikluara. Ndër të tjera, grupet e nxënësve do të jenë përkujdesës për kioskat që u ndërtuan në 2 shkolla publike “28 Nëntori” dhe Adem Haxhija në Postribë. Qëndrushmëria ishte elementi që vajzat theksuan, duke e konsideruar si një nismë e cila ka potencial për t’u përhapur dhe zbatuar në shkolla të tjera të qytetit.

Në të njëjtën linjë, “Albanian Craftman Education” prezantoi një model të fuqishëm të ndërlidhjes së traditës me mjedisin përmes një marketspace për 15 gra të zonave rurale. Elementët kryesorë të projektit *“Makerspace për Gratë – Riciklim & Ridesign Lëkure”* ishin riciklimi dhe ridizajnimi i lëkurës, duke i kthyer këto materiale në ekonominë lokale me një nivel të lartë përfshirjeje. Ky projekt kontribuoi në fuqizimin e grave për t’u vetpunësuar dhe forcuar kapacitetet e tyre duke rritur shanset për punësim në zonat e tyre.

Po ashtu, projekti *“ Ri-fill - Fuqizim ekonomik për gratë përmes riciklimit të tekstileve në produkte të tregtueshme ”* zbatuar nga *“Together For Life”* tregoi se si fuqizimi ekonomik i grave mund të arrihet përmes riciklimit të tekstileve, duke krijuar hapësira për vetëpunësim dhe menaxhim. Nga ana tjetër, ky projekt prezantoi mënyra të ndryshme për ripërdorimin dhe rikthimin e produkteve të përdorura në vlerë, duke demonstruar se si praktikatat e ekonomisë qarkulluese mund të sjellin përfitime konkrete si për komunitetet, ashtu edhe për mjedisin.

Një zbulim i vlefshëm erdhi edhe nga Environmental & Territorial Management Institute (ETMI) nëpërmjet projektit

“Fuqizimi i grave në zonat rurale nëpërmjet praktikave të ekonomisë qarkulluese” i cili u fokusua tek gratë fermere në Prrenjas dhe përfitimin e tyre nga punishtja e parë për peletim, duke i trajnuar ato për kthimin e mbetjeve bujqësore në ushqim bagëtiesh. Ky model krijoi një mundësi konkrete për Bashkinë Prrenjas, duke kontribuar në forcimin e ekonomisë lokale, si dhe për gratë e zonës, të cilat e panë këtë nismë si një mundësi për punësim dhe përfshirje ekonomike. Punishtja e peletimit arriti të prodhonte produktet e para dhe t'i ofronte ato në treg, duke hedhur bazat për një aktivitet të qëndrueshëm ekonomik.

Aktiviteti u përmyll me identifikimin e sfidave dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i këtyre projekteve, eksperiencat e organizatave implementuese ishin sa të ndryshme aq edhe të njëjta duke identifikuar sfida dhe duke ofruar rekomandime të vlefshme për të gjithë zbatuesit. Suksesi më i madh nuk ishte vetëm ndarja plot pasion e këtyre lëvizjeve, por edhe mënyra se si ato u përcollën te të tjerët.

Të gjithë u angazhuan dhe informuan mbi çështje të ndryshme, por bazat u evidentuan si të njëjta, të përmirësojmë jo vetëm vendin ku jetojmë, por edhe shoqërinë ku bëjmë pjesë. Siç u shprehën edhe përfaqësuesit gjatë takimit, është thelbësore t'i japim mundësi njëri-tjetrit për t'u aktivizuar dhe për të mos pasur ngurim të fillojmë një nismë të re. Elementët që pjesëmarrësit morën nga kjo platformë e shkëmbimit të ideve ishin: *“ vlera ”*, *“ frymëzim ”*, *mirënjohje*, *“bashkëpunim”*, *“motivim”*, *“gjithëpërfshirje”*.

Ky projekt na tregoi se ekonomia qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore mund të jetë një realitet i prekshëm për dhe me komunitetet tona.